



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K2/M6-5 Prot.
Nr. Dok.202502470/5

Tiranë 03/08/2025

Lënda: Rekomandim për marrjen e masave administrative për vlerësimin e rastit të paditësit M.S, duke parë mundësinë për caktimin e një date për shqyrtimin e çështjes

GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË APELIT
Tiranë

Për dijeni: KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
Tiranë

Të nderuar,

Në institucionin e Avokatit të Popullit është paraqitur ankesa e shtetasit M.S, i cili ka kërkuar respektimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, përse i përket respektimit të afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes gjyqësore nga Gjykata Administrative e Apelit.

Nga data e regjistrimit të kësaj çështjeje në këtë gjykatë dhe deri tani kanë kaluar gati 5 vite.

I. Rrethanat e çështjes

Ankuesi M.S parashtrohet se ka pasur një problematikë me Sigurimet Shoqërore Kukës, pasi si pasojë e punësimit, atij i kanë ndaluar padrejtësisht disa pagesa të pensionit të minatorit. Lidhur me këtë çështje, ai ka paraqitur fillimisht në vitin 2019 kërkesëpadinë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër e ka rrëzuar kërkesën dhe si pasojë ai ka bërë ankim në Gjykatën

Administrative të Apelit në Tiranë në vitin 2020 me të paditur Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Kukës.

Pas interesimit të tij, nëpërmjet përfaqësuesit të Zyrës Rajonale Kukës të Avokatit të Popullit, ka marrë një informacion me telefon nga gjykata që prej vitit 2020 dhe deri më tani nuk është caktuar një datë për gjykimin e çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit. Aktualisht relator i çështjes është caktuar gjyqtar Sokol Ibi.

Pas paraqitjes së ankesës dhe adresimit nga ana jonë të kërkesës për informacion nr.K2/M6-2 prot., datë 15.04.2025 në Gjykatën Administrative të Apelit, me përgjigjen e tyre nr.2987/1 prot., datë 25.04.2025 na informojnë se, nga verifikimet e kryera në Gjykatën Administrative të Apelit rezulton se është regjistruar çështja nr.*** (*****-*****-**-*****) akti datë 10.09.2020, me palë:

Kërkues:	M.S
Person i Tretë:	Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Kukës Instituti i Sigurimeve Shoqërore Tiranë
Palë e interesuar:	Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Shkodër
Objekti:	Sqarimin dhe interpretimin e vendimit nr.*** (***), datë 20.05.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Detyrimin e personit të tretë DRSSH Kukës të më kthejë shumën e plotë të kësteve të mbajtura padrejtësisht dhe të pakthyerat mijë lekë sipas vendimit të gjykatës administrative dhe jo vetëm për një pjesë të saj siç ka vepruar.

Pas procedurës së rishortimit, çështja e mësipërme më datë 06.11.2024 i ka kaluar për gjykim gjyqtarit Sokol Ibi dhe aktualisht ende nuk ka datë të planifikuar për gjykim. Shkresa e paraqitur nga ana e institucionit tonë iu bë me dije gjyqtarit relator.

Ankuesi kërkon shqyrtimin brenda një afati të arsyeshëm të kësaj çështjeje. Prej vitit 2020 kur kjo çështje është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit e deri më sot, kanë kaluar gati 5 vjet dhe ende nuk është caktuar një datë për gjykimin e saj.

II. Kuadri ligjor dhe nënligjor në fuqi

Në ligjin nr.49/2012 *“Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, i ndryshuar, konkretisht në nenin 3 të tij, renditet si një ndër parimet themelore të gjyimit administrative **sigurimi i një procesi të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme**, kjo me synimin për të garantuar një mbrojtje efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshme të personave.

Nga ana tjetër, në Kodin e Procedurës Civile, i cili përcakton rregulla të detyrueshme, të njëjta dhe të barabarta, për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile e të mosmarrëveshjeve të tjera, me ndryshimet e vitit 2017, i është kushtuar vëmendje e veçantë çështjes së

respektimit të afatit të arsyeshëm të gjykimit, duke e trajtuar këtë institut në një kre të veçantë. Në dispozitën e nenit 399/2, pika 1 të këtij ligji përcaktohet se:

“1. Afate të arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, për qëllimet e përcaktuara në nenin 399/1, do të konsiderohen:

a) në gjykimin administrativ në shkallën e parë dhe në apel, përfundimi i gjykimit brenda një viti nga fillimi i tij në secilën shkallë;

b) në gjykimin civil në shkallë të parë përfundimi i procesit të gjykimit brenda dy viteve, në gjykim civil në apel brenda dy vjetëve; dhe gjykimin civil në Gjykatën e Lartë, brenda dy vjetëve;”

Dispozitat e lartpërmendura të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit nr.49/2012, kanë si qëllim vendosjen për herë të parë të standardeve, si dhe një kufi në raport me termat kohorë lidhur me gjykimin brenda afatit të arsyeshëm. Kështu, në çdo rast, sipas dispozitës së nenit 399/2 të Kodit të Procedurës Civile, **gjykimi administrativ në shkallën e parë dhe në apel nuk mund të zgjasë më tepër se një vit nga fillimi i tij në secilën shkallë.**

Neni 42 i Kushtetutës parashikon ndër të tjera se kushdo për mbrojtjen e të drejtave ligjore ka të drejtën e një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse¹.

Në vendimin nr.16, datë 03.04.2025 të Gjykatës Kushtetuese² është konstatuar cenimi i të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm për kërkuesin, pasi ende nuk ka një datë planifikimi për shqyrtimin e çështjes së tij dhe as një vendimmarrje nga Gjykata Administrative e Apelit.

Kështu, gjykata ka konstatuar se çështja ka për objekt marrëdhëniet e punës, të cilat shqyrtohen me përparësi nga gjykata, për më tepër që, në rastin konkret, janë tejkaluar edhe afatet maksimale të përcaktuara nga ligji, duke u zgjatur më shumë se 2 vjet.

Duke iu referuar nenit 399/2, pika 1, shkronja “a”, të KPC-së, Gjykata vë në dukje se kohëzgjatja e gjykimit të çështjes së kërkuesit ka tejkaluar afatin 1-vjeçar të përcaktuar nga ligji si i arsyeshëm për përfundimin e gjykimit administrativ në apel. Në këto rrethana, për të vlerësuar nëse kërkuesit i është cenuar e drejta kushtetuese për gjykim brenda afatit të arsyeshëm. Gjithashtu, gjykata ka analizuar rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e kërkuesit;

¹ Vendimi nr.57, datë 17.09.2024 i Gjykatës Kushtetuese
Vendimi nr.2, datë 17.02.2022 i Gjykatës Kushtetuese
Vendim nr.33, datë 01.11.2021 i Gjykatës Kushtetuese

² Vendimi nr.16, datë 03.04.2025 i Gjykatës Kushtetuese

(ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi³.

Për sa i takon sjelljes së kërkuesit, merr rëndësi të analizohen rrethanat nëse ai ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur ose jo interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nëse është bërë shkak ose ka shkaktuar vonesa në këtë drejtim.

Në lidhje me kompleksitetin e çështjes, Gjykata vëren se çështja ka në objektin e saj kërkimin për përfitimin e pagesave të rrjedhura nga paga referuese dhe nga diferencat e pagave të papaguara. Palë të paditura në gjykim janë dy institucione shtetërore, KLGJ-ja dhe Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Në thelb, çështja lidhet me përcaktimin e fakteve bazuar në dokumente dhe në interpretimin e një numri të kufizuar normash ligjore pa pasur nevojë për marrjen e provave voluminoze dhe as për ndërthurje të shumta aktesh ligjore. Duke iu referuar këtyre aspekteve, Gjykata vlerëson se çështja e kërkuesit nuk paraqitet komplekse.

Për sa i përket sjelljes së autoriteteve, konstatohet se procesi gjyqësor është vënë në lëvizje nga kërkuesi. Ky lloj kërkimi përfshihet në grupin e çështjeve që shqyrtohen me përparësi nga gjykata e apelit, i klasifikuar si i tillë në kalendarin e miratuar nga KLGJ-ja (shkronja “gj” e pikës 3.1 të vendimit nr. 78, datë 30.05.2019 “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit”, të ndryshuar [vendimi nr. 78/2019]).

Ashtu sikurse ka vlerësuar edhe gjykata kushtetuese në çështje të ngjashme, në lidhje me atë çfarë rrezikon kërkuesi në procesin gjyqësor, disa çështje që lidhen me interesa “vetjakë e jetësorë” nevojitet të trajtohen me shpejtësi e përparësi, të tillë si ato që kërkojnë “kujdes të veçantë” ose “kujdes të jashtëzakonshëm” dhe që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme dhe pensionin. Lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe kriteri i interesit të kërkuesit në proces verifikohet nga Gjykata rast pas rasti⁴.

Po kështu, KLGJ-ja, në qasje me jurisprudencën evropiane, e cila ka çmuar se disa mosmarrëveshje për nga natyra e tyre, kërkojnë vendimmarrje të përsheptuar dhe i ka listuar ato si çështje prioritare për shqyrtim nga gjykata e apelit në vendimin e saj nr.78/2019.

Në pikën II/2 të këtij vendimi përcaktohet se:

³ Vendim nr. 46, datë 03.10.2023 i Gjykatës Kushtetuese

Vendim nr. 6, datë 16.02.2023 i Gjykatës Kushtetuese

Vendim nr. 13, datë 26.05.2022 i Gjykatës Kushtetuese

⁴ Vendimet nr.43, datë 04.06.2024 i Gjykatës Kushtetuese

Vendim nr.21, datë 04.04.2024 i Gjykatës Kushtetuese

Vendim nr.6, datë 16.02.2023 i Gjykatës Kushtetuese

“Gjyqtari relator cakton datën në përputhje me kalendarin e tij të shqyrtimit të çështjeve duke mbajtur parasysh kërkesat për përshpejtim ose listën e grupçështjeve të miratuara nga Këshilli i Gjykatës. Kriteret që mban parasysh gjyqtari relator për vlerësimin e shkaqeve për përshpejtim të parashtruara nga palët lidhen në veçanti me natyrën dhe kategorinë specifike të çështjes.”

Sjellim në vëmendje se kohët e fundit GJEDNJ-ja ka konstatuar në shumë raste të çështjeve me individë të ndryshëm kundër shtetit shqiptar se është shkelur paragrafi 1, i nenit 6 të Konventës, në lidhje me kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore në fjalë.

Kështu, në çështjet **Papakostandini kundër Shqipërisë** (kërkesa nr. 7568/08)⁵ dhe **Fortuzi kundër Shqipërisë** (kërkesa nr.29237/18)⁶ GJEDNJ shprehet që është shkelur paragrafi 1, i nenit 6 të Konventës, në lidhje me kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore në fjalë.

Po ashtu në muajin tetor 2021, GJEDNJ ka vendosur për rastin e dy kërkuesve, *Bara and Kola v.Albania*, shtetas shqiptarë që janë ankuar pranë këtij institucioni për kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore në Shqipëri. Kjo Gjykatë ka vendosur se në këto raste *është shkelur e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*.⁷

Duke mos shpërfillur vonesën e kuptueshme që rrjedh nga reformat e thella të sistemit të drejtësisë dhe procesi i vettingut, Gjykata ripohoi **se shtetet kishin një detyrim të përgjithshëm për të organizuar sistemet e tyre ligjore në mënyrë që të siguronin përputhjen me kërkesat e nenit 6 paragrafi 1 të Konventës, duke përfshirë atë të një gjykimi të drejtë brenda një afati të arsyeshëm**.

Lidhur me sjelljen e gjykatave të brendshme, GJEDNJ me vendimet e saj ka vendosur standardin se gjykatat që trajtojnë çështjen nuk duhet të marrin më shumë se tre vjet kohë për të dhënë vendimin e tyre⁸.

III.Konstatimet e Avokatit të Popullit

Në rastin objekt i rekomandimit, kërkuesi është interesuar në gjykatë, edhe nëpërmjet përfaqësuesit të Zyrës Rajonale Kukës, si dhe është lajmëruar nga gjykata me telefon për gjyqtarin relator dhe statusin e çështjes.

Mosgjykimi i çështjes gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm, 5 vjet nga regjistrimi i kësaj çështjeje në Gjykatën Administrative të Apelit, cenon të drejtën e ankuesit për një proces të rregullt ligjor.

⁵<https://www.avokaturashtetit.gov.al/vendimet-e-strasburgut/vendimet-e-gjykates-evropiane-per-te-drejtave-te-njeriut-strasburg>

⁶<https://www.avokaturashtetit.gov.al/vendimet-e-strasburgut/vendimet-e-gjykates-evropiane-per-te-drejtave-te-njeriut-strasburg>

⁷ *Bara and Kola v. Albania* - [43391/18](#) and [17766/19](#), Judgment 12.10.2021

⁸ L.Z. kundër Sllovakisë (vendim), nr. 27753/06, 27 shtator 2011 dhe Lyszczyna kundër Gjermanisë (vendim), nr.34863/04, 4 janar 2008)

Vonesa e konstatuar është e theksuar, ndaj vlerësojmë të rëndësishëm respektimin e parimit, sipas së cilit gjykata duhet të realizojë një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm **brenda një afati të arsyeshëm, për të garantuar kështu të drejtat e qytetarëve.**

Në vlerësimin tonë, e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm ligjor është një ndër të drejtat themelore të qytetarëve shqiptarë. Për këtë arsye, e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nuk është dhe nuk duhet të mbetet një e drejtë apo garanci deklarative, por është standard kushtetues, i garantuar dhe sanksionuar në aktet që përcaktojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si në nivel ndërkombëtar (neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut), ashtu edhe në të drejtën e brendshme (neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë⁹).

Në legjislacionin e brendshëm shqiptar, ashtu sikurse në disa legjislacione evropiane, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara nga GJEDNJ, janë parashikuar edhe mjete të veçanta ankimi, me qëllim përshpejtimin e proceseve gjyqësore. Një nga këto mjete është edhe padia e veçantë e parashikuar në Kodin e Procedurës Civile lidhur me zgjatjen e procesit tej afatit të arsyeshëm.

Me anë të këtij ankimi pala e interesuar ka mundësinë për të ndikuar drejtpërdrejt në një përshpejtim të procesit. Me anë të kësaj padie, qytetari jo vetëm konstaton tejzgjatjen pa arsye të procesit, por mund të marrë dhe dëmshpërblim (nëse e kërkon) për vonesën e shkaktuar. Vendimi në këtë rast urdhëron gjykatën kompetente ta shqyrtojë çështjen sa më parë. Natyrisht, në disa raste tejzgjatja e procesit gjyqësor ka shkaqe objektive. Në një rast të tillë kjo padi mund të bëhet shkak për evidentimin e arsyeve konkrete dhe ndoshta edhe për eliminimin e tyre nga organet kompetente. Pra, ky mjet duhet konsideruar me efekt parandalues, në rast të tejzgjatjes pa shkak të procesit, pra që çdo individ ka një mjet efikas që do t'i vijë në ndihmë.

Palët duhet të mbrohen nga zvarritjet e paarsyeshme të procedurave, por mbi të gjitha t'iu garantohet se brenda një afati të arsyeshëm pala kërkuese do të përfitojë eventualisht nga të drejtat që i janë mohuar, duke i mundësuar asaj siguri juridike në raport me pozitën procedurale. Për më tepër, gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, përveçse është një standard të cilin organi gjyqësor ka detyrimin ta respektojë *apriori*, është mbi të gjitha një standard që vlerësohet në mënyrë të veçantë për secilin rast konkret, nisur nga specifika, kompleksiteti, tërësia e të drejtave të shkelura apo të pretenduara, etj.

Për gjithë sa parashtruam, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë*

⁹ Në nenin 42 të Kushtetutës parashikohet se:

1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.
2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe të lirive nga administrata publike”, si dhe në ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 “Për avokatin e Popullit”, i ndryshuar, neni 21/b në të cilin parashikohet: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”:

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave administrative për vlerësimin e rastit të kërkesit M.S, duke parë mundësinë për caktimin e datës për shqyrtimin e çështjes gjyqësore.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Besnik DEDA

D.V